

## Termet e Referencës

Trajnimi: Fuqizimi i kapaciteteve të organizatave partnere për avokim për të drejtat e fëmijëve gjatë krizave

### I. HYRJE

HANDIKOS, “Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës” është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden personat me aftësi të kufizuara në Kosovë, e themeluar nga dhe për personat me aftësi të kufizuara, me aktivitete të pandërprera që nga viti 1983.

Si organizatë përfaqëson, përkrah dhe punon për dhe me personat me aftësi të kufizuara përmes avokimit dhe lobimit. Ofron shërbime të ndryshme përmes rrjetit të shtrirë në gjithë Kosovën dhe promovon barabarësinë, jetën e pavarur dhe me dinjitet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

### II. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

HANDIKOS në partneritet me Save the Children në Kosovë është duke implementuar projektin “Advancing Rights and Participation of Children with Disabilities in Kosovo”, i cili financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (SIDA). Projekti përqendrohet në ndërtimin e kapaciteteve të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të monitoruar të drejtat e tyre dhe për të ndikuar në vendimmarrje në nivel lokal.

### III. OBJEKTIVA E DETYRËS

HANDIKOS është duke organizuar një trajnim me organizatat partnere me qëllim fuqizimin e kapaciteteve të tyre për avokim për të drejtat e fëmijëve gjatë periudhave të krizës. Ky aktivitet vjen si përgjigje ndaj nevojës për të forcuar aftësitë e organizatave të shoqërisë civile për të reaguar në mënyrë efektive dhe të koordinuar në situata të ndryshme krize, përfshirë krizat ekonomike, politike, mjedisore apo emergjencat e tjera që ndikojnë drejtpërdrejt te fëmijët.

Në këto kontekste, avokimi i bazuar në të drejtat e njeriut kërkon qasje të përshtatura, menaxhim të rrezikut dhe komunikim të qartë e të fuqishëm që e vendos fëmijën në qendër të ndërhyrjeve.

Trajnimi synon të:

- Forcojë kuptimin e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut në kontekstet e krizave;
- Rrisë kapacitetet për identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve në proceset e avokimit;
- Përmirësojë aftësitë për ndërtimin e narrativave të fuqishme dhe të përshtatura për situata emergjente;
- Pajisë organizatat me mjete praktike për adaptimin e strategjive të avokimit në kushte të paqëndrueshme.

#### IV. KUALIFIKIMI

Ekspteri/ja i/e angazhuar për këtë aktivitet duhet të ketë:

- Përvojë të dëshmuar në fushën e të drejtave të fëmijëve/të njeriut;
- Përvojë në avokim, me fokus në kontekste të krizave (ekonomike, politike, mjedisore apo emergjenca të tjera);
- Njohuri të thelluara mbi qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut dhe qasjet pjesëmarrëse;
- Aftësi të mira facilitimi dhe pune me grupe pjesëmarrëse;
- Njohuri mbi menaxhimin e rrezikut në avokim dhe komunikimin strategjik;
- Përparësi konsiderohet njohja me kontekstin e Kosovës dhe punën me grupet e cënueshme.

#### V. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Ekspteri/ja i/e angazhuar për këtë aktivitet do të ketë këto detyra dhe përgjegjësi:

- Të përgatisë agjendën dhe metodologjinë e detajuar të trajnimit, në koordinim me HANDIKOS;
- Të zhvillojë materialet e trajnimit në përputhje me objektivat e aktivitetit;
- Të facilitojë trajnimin në mënyrë interaktive, duke siguruar pjesëmarrje aktive të organizatave partnere;
- Të udhëheqë sesionet mbi menaxhimin e rrezikut në avokim dhe ndërtimin e narrativave efektive;
- Të përgatisë një raport përmbledhës pas trajnimit, duke përfshirë rezultatet kryesore dhe rekomandimet për hapat e ardhshëm;
- Të sigurojë koordinim të vazhdueshëm me stafin e HANDIKOS gjatë gjithë procesit të përgatitjes dhe zbatimit të trajnimit.

#### VI. ANGAZHIMI I ESKPERTIT/ES

Ekspteri/ja do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me HANDIKOS. Angazhimi do të bëhet gjatë muajit Maj 2026 në bazë ditore, ku do të përfshihen aktivitetet e mëposhtme:

Detyra	Kohëzgjatja
Përgatitja e metodologjisë, agjendës dhe materialeve të trajnimit	2 ditë
Fasilitimi i trajnimit	1 ditë
Hartimi i raportit të trajnimit	1 ditë
TOTALI	4 ditë

## VII. KUSHTET E PAGESËS

Pagesa do të bëhet pas përfundimit të aktivitetit dhe dorëzimit të raportit final të aprovuar nga HANDIKOS.

HANDIKOS do të realizojë pagesën në Euro, shuma bruto për ditët e punës (nga të cilat do të ndalet tatimi në fitim dhe kontributi pensional sipas ligjeve në fuqi në Kosovë).

*HANDIKOS rezervon të drejtën e negociimit të propozimit financiar.*

## VIII. PROCEDURA PËR APLIKIM

- Metodologjia e punës për këtë angazhim;
- Curriculum Vitae (CV);
- Propozimi financiar.

Aplikimet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: [nora.simitciu@handi-kos.org](mailto:nora.simitciu@handi-kos.org).  
Ju lutem, shkruani në subjekt: Fuqizimi i kapaciteteve të organizatave partnere për avokim.

**Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit është 13 maj.**

**Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen!**

Pas përzgjedhjes Eksperti/ja i përzgjedhur duhet të dërgojë:

- **Dokumentin/ Dëshminë që nuk jeni nën hetime.**
- Poashtu duhet të nënshkruaj **Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve** si dhe **Rregulloren mbi Parandalimin e Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual — PSHAS** dhe t'u përmbahen kushteve dhe kriterëve të tyre.